



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	20.01.2023
REFERENC-Ë:	21/2860/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Fabrika e mobileve Sela Impex" SH.P.K. Nekodim-Ferizaj Fabrika për prodhimin e mobileve ne Nekodim-Ferizaj
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Fabrika e mobileve Sela Impex" SH.P.K., me Nr. Prot. 21/775/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

1. Vendimi për Refuzimin e Lejes Mjedisore për operatorin "Fabrika e mobileve Sela Impex" SH.P.K. Nekodim- Ferizaj, për fabrikën për prodhimin e mobileve ne Nekodim- Ferizaj.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE			
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org. Unit	SP-02	Nr. i Prot. Prot. No.	2860-2/21
Nr. i Faqeve Br. Stranica	03	Data Date	03.02.23
PRISHTINË / A			No. 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 21/775/MMPHI
Datë: 20.01.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 12 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me Nr. 15/1608/1-ZSP/102/15, të lëshuar me dt. 17.06.2015, si dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore të datës 13.01.2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "Fabrika e mobileve Sela Impex" SH.P.K. Nekodim- Ferizaj i refuzohet kërkesa për pajisje me Leje për fabrikën për prodhimin e mobileve në ngastrën kadastrale nr. P- 72217062- 00563-0 dhe nr. P- 72217062- 00564- 1, zona kadastrale Nekodim- Ferizaj.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Fabrika e mobileve Sela Impex" SH.P.K. Nekodim- Ferizaj për fabrikën për prodhimin e mobileve në ngastrën kadastrale nr. P- 72217062- 00563-0 dhe nr. P- 72217062- 00564- 1, zona kadastrale Nekodim- Ferizaj, është konstatuar se operatori nuk i plotëson kriteret e parapara me Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, pasi që mungon Certifikata e përdorimit, Leja Ndërtimore, ose një dokument nga komuna që komuna lejon zhvillimin e veprimtarisë në parcelat sipas kërkesës që është parashtruar për të.

Faqe 2 nga 3



pajisur me Leje Mjedisore dhe Pëlqimit Mjedisor Nr. 15/1608/1-ZSP/102/15, të datës 17.06.2015.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, merr Vendim për refuzimin e Lejes Mjedisore ne përputhje me paragrafin 3 te nenit 12, te Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Servet Spahiu

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Ferizaj;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjes e Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zaštitu Sredine i Voda / Department of Environment Protection and Waters

REFERENC-Ë:	21/775/64/MMPHI-DMMU
DATE/A:	20.01.2023
PËR/ZA/TO:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ismail Hetemaj, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së
NGA/OD/FROM:	Hana Imeri, kryesuese e komisionit për Leje Mjedisore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje lidhur me Leje Mjedisore për operatorin "Fabrika e mobileve Sela Impex" SH.P.K. Fabrika për prodhimin e mobileve Nekodim- Ferizaj

Te nderuar,

Bashkëlidhur gjeni lëndën me nr. Protokolli: nr. prot. 22/775/64/MMPHI-DMMU, të operatorit "Fabrika e mobileve Sela Impex" SH.P.K., për fabrikën për prodhimin e mobileve ne Nekodim- Ferizaj.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zivotnu Sredinu i Vodu/
Department of Environment Protection and Water

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENC-Ë:		21/775/64/MMPHI-DMMU			
PËR/ZA/TO:		Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Ismail Hetemaj, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së			
NGA/OD/FROM:		Komisioni për Leje Mjedisore			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Përgjigje ne kërkesën e operatorin "Fabrika e mobileve Sela Impex" SH.P.K. Nekodim- Ferizaj Fabrika për prodhimin e mobileve ne Nekodim- Ferizaj			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	1517	Lokacioni: Kucni: Extension:	Ish pallati i mediave Rilindja, Prishtinë.	Data: Datum: Date:	20.01. 2023
PËR AKTIVITET/ ZA AKTIVNOST/ FOR ACTION					☐
PËR MIRATIM/ ZA USVAJANJE/ FOR APPROVAL					☒
PËR NËNSHKRIM/ ZA POTPIS/ FOR SIGNATURE					☒
PËR KOMENTE/ ZA KOMENTARE/ FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/ DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/ MAY ËE DISCUSS					☐
VËMENDJA JUAJ/ VASA PAZNJA/ YOUR ATTENTION					☐
SIPAS DISKUTIMIT/ KAKOJE RASPRAVLJENO/ AS DISCUSSED					☒
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/ KAKO JE ZATRAZENO/ AS REQUESTED					☒
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/ BELESKA I ODGOVOR/ NOTE AND RETURN					☒
PËR INFORMIMIN TUAJ/ ZA VASU INFORMACIJU/ FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/ KRAJNI ROK/ DEADLINE					

I nderuari Sekretar,

Komisionit për Leje Mjedisore i emëruar me Vendimin Nr. 83/2022, me nr. prot. 4306/2022, të dt. 01.08.2022, duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, në afatin e paraparë ligjorë, jep këtë Mendim Profesional:

Operatori "Fabrika e mobileve Sela Impex" SH.P.K, Nekodim- Ferizaj ka aplikuar për tu pajisur me Leje Mjedisore, me Nr. Prot. 21/775/64/MMPHI-DMMU për fabrikën për prodhimin e mobileve në ngastrën kadastrale nr. P- 72217062- 00563-0 dhe nr. P- 72217062- 00564- 1, zona kadastrale Nekodim- Ferizaj, sipas Pëlqimit Mjedisor me Nr._15/1608/1-ZSP/102/15, të lëshuar me dt. 17.06.2015.

Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 56, datë 19.11.2015, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim mjedisor me Nr._15/1608/1-ZSP/102/15, të lëshuar me dt. 17.06.2015;
- Raport i analizave të pluhurit total të depozituar;
- MPMS – Pëlqim për punë, me nr. 114/11 të lëshuar me dt. 19.07.2011, për prodhimin e mobileve të kuzhinës;
- Kontratë për kryerjen e shërbimeve ndërmjet Fabrika e mobileve "Sela Impex" dhe "Mbrotja e ambientit" SH.P.K., me nr. 101/2022 të dt. 03.01.2022, për bartjen e mbeturinave;
- Raport i matjeve të emisioneve në ajër të shkarkuara nga impianti me lëndë djegëse të ngurtë;
- Komuna Ferizaj- Leje Pune, me nr. 05 nr. 1634/039 të lëshuar me dt. 19.02.2009;
- Komuna Ferizaj- Kërkesë nga Kabineti i Kryetarit Ferizaj- Inspektorati Tregut me nr. 3109 të lëshuar me dt. 17.10.2022, Komisionit për pranimin teknik të lokaleve afariste, që të dal në vend të ngjarjes dhe të bëjë verifikimin në lidhje me plotësimin e kushteve minimalo-teknike për subjektin afarist;
- Komuna Ferizaj- Vendim me nr. 5052 të lëshuar me dt. 18.10.2022, Pëlqimi për ushtrimin e veprimtarisë biznesore (pa parcela kadastrale);
- Komuna Ferizaj- Vërtetim me nr. 22514240 të lëshuar me dt. 17.10.2022, me të cilin vërtetohet se tatimpaguesi i ka kryer pjesërisht/plotësisht obligimet e tatimit në pronë;
- Komuna Ferizaj- Vërtetim me nr. 05- 435- 1308 të lëshuar me dt. 17.10.2022, për regjistrimin e biznesit.

Komisioni për Leje Mjedisore ka realizuar vizite te operatori, për verifikimin e kushteve mjedisore me dt. 29.07.2022.

Komisioni pas realizimit te vizites në teren ka kërkuar nga kompania plotesim e dokumentacionit dhe kushteve te cekura me poshtë:

- Pikat e aplikacionit te përimitohen: 2.1.7; 5.1; 5.1.1; 5.1.2; 5.1.4; 5.1.5;
- Certifikatën e përdorimit (Lejen Ndërtimorë, ose një dokument nga komuna për lejin e ushtrimit të veprimtarisë në përputhje me veprimtarin dhe parcelat sipas kërkesës që keni bërë për tu pajisur me Leje Mjedisore dhe Pëlqimit Mjedisor Nr. 15/1608/1-ZSP/102/15, të datës 17.06.2015;
- Raportin e pluhurit.

Operatori nuk ka sjellë dëshmi për plotësimin e gjithë dokumentacionit të cekur me lartë.

Si përfundim mungon:

- Certifikatën e përdorimit, Lejen Ndërtimorë, ose një dokument nga komuna qe komuna lejon zhvillimin e veprimtarisë ne parcelat sipas kërkesës që është parashtruar për tu pajisur me Leje Mjedisore dhe Pëlqimit Mjedisor Nr. 15/1608/1-ZSP/102/15, të datës 17.06.2015.

Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës te operatorit në fjalë duke përfshirë aplikacionin, dokumentacionin përcjellës qe nevojitet për pajisje me leje mjedisore dhe gjendjes faktike në teren, në takimin e komisionit te mbajtur me dt. 13.01.2023, në përbërje prej pesë (5) anetarëve, unanimisht, konstatojnë se operatori nuk i ka sjell të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, gjithashtu operatori nuk ka plotësuar të gjitha kushtet mjedisore dhe si përfundim, rekomandon që ti refuzohet Leja Mjedisore.

Bashkangjitur këtij Mendimi Profesional gjeni edhe propozim vendimin për refuzimin e Leja Mjedisore.

Komisioni:

Hana Imeri, kryesuese

Adem Tusha, anëtar-

Fatmir Bytyqi, anëtar-

Përparim Terziu, anëtar

Lindita Morina, anëtare

